



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 26, datë 08/06 /2020

PËR

NJË NDRYSHIM NË VSA NR. 15, DATË 07.02.2020 MBI DEKLARIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR DHE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER I ARTEVE, MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të nenit 38 funksionet e Senatit Akademik, pika 3 e Nenit 69 e vijim të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të pikës 3, të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë" të VSA Nr. 15, datë 7.02.2020, si dhe nisur nga shkresa e Dekanit të Fakultetit të Muzikës me nr.133 prot., datë 05.06.2020 me lëndë "Propozimet për shtesë të kuotave të konkurseve të pranimit, për programet e studimit Bachelor, për vitin akademik 2020-2021 në FM"; si dhe mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Senati Akademik, pasi diskutoi mbi këtë propozim, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtimit të kuotave, të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor, për kandidatët brenda vendit, në programet e studimit Kanto, Violinë dhe Pedagogji Muzikore, për vitin akademik 2020-2021, në Fakultetin e Muzikës.
2. Bashkëlidhur propozimi për shtimin e kuotave nga Fakulteti i Muzikës.
3. Ky Vendim, të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, në portalin U-Albania si dhe të përcillet në MASR së bashku me tabelën për shtimin e numrit të kuotave në programet e studimeve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor, në FM.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Asoc. Genc MULLIQI

Urim ALIAJ

Rajmond PRENDUSHI

04.5.2020
e 8.06.2020 / 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANI

Nr. Prot. 133

Tiranë, më 05 / 06 2020

Lënda: Propozimet për shtesë kuotash të konkurseve të pranimit, për programet e studimit "Bachelor" për vitin akademik 2020-2021 në FM.

Drejtuar: Prof. Kastriot Çausi
Kryetar i Senatit Akademik

Për dijëni : Zv/Rektorit të UART, Prof. Dr. Erald Bakalli

I nderuar z.Çausi,

Bashkangjitur po ju përcjellim kërkesën e Departamenteve Bazë të Fakultetit të Muzikës, për shtim kuotash për kandidatët brenda vendit në programet e studimit Kanto, Violinë dhe Pedagogji Muzikore për vitin akademik 2020-2021.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret pasqysh nga ana Juaj.

Prof. Dr. Isak SHEHU

Dekani i Fakultetit të Muzikës





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS**

Nr. 132 prot.

Tiranë, më 4.6 2020

**Lënda: Mbi një ndryshim në kuotat e pranimeve për programet e studimit Kanto,
Violinë, Pedagogji Muzikore për vitin akademik 2020-2021**

**Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Muzikës
Prof. Dr. Isak Shehu**

I nderuar z. Shehu

Në vitet e fundit akademike, në programe të caktuara studimi pranë Fakultetit të Muzikës në Ciklin I (Bachelor), është vërejtur pamundësia e një pjese të kandidatëve për tu regjistruar në konkursin e pranimit të fazës së parë. Këto problematika, bazur në komunikimet e herë pas herëshme me një pjesë të kandidatëve të sipërpërmendur, kryesisht vijnë si rrjedhojë e fazave të ndryshme të aplikimit për regjistrim dhe përmbylljes së detyrimeve, që kanë këta kandidatë, në lidhje me institucionet arsimore pranë të cilave kanë kryer studimet.

Bazuar në sa më sipër, pasi jemi njohur me problematikën e mësipërme, dëshirojmë të parashtrojmë kërkesën për shtim kuotash, për kandidatët brenda vendit, në programet e studimit Kanto, Violinë dhe Pedagogji Muzikore për vitin akademik 2020-2021. Më konkretisht:



1. Programi i Studimit Kanto parashikon një shtesë kuotash me 7 studentë, pra, bazuar në kërkesën e mëparshme, në total numri i kuotave shkon 29 studentë.
2. Programi i Studimit Violinë parashikon një shtesë kuotash me 3 studentë, pra, bazuar në kërkesën e mëparshme, në total numri i kuotave shkon 17 studentë.
3. Programi i Studimit Pedagogji Muzikore parashikon një shtesë kuotash me 1 studentë, pra, bazuar në kërkesën e mëparshme, në total numri i kuotave shkon 16 studentë.

Me konsideratë,

Prof. Asoc. Dorian Çene
Përgjegjës i Njesisë Bazë KMDP

Prof. Arben Llozi
Përgjegjës i Njesisë Bazë Interpretim

Prof. Asoc. Kastriot Tusha
Përgjegjës i Njesisë Bazë Kanto



Kuotat për Vitin Akademik 2020 - 2021
CIKLI I PARË "BACHELOR" PRANIMET E REJA

IAL																			
Njësia Kryesore																			
Programi i Studimit																			
Bachelor																			
Forma e Studimit (Kohë e Plotë)																			
Kapacitetet Maksimale Pritëse për Programin e Studimit																			
Kuota për kandidatë Brenda territorit të																			
1	2																		
KUOTAT NGA TROJET SIPAS SHITETEVE		Kosovë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
		Maqedoni	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Mali i Zi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Preshevë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Bujanovc	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
		Medvegjë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kandidatë shtetas të huaj	3																		
Kandidatë me statusin e personit me aftësi të	4																		
Kandidatë me statusin e jetimit	5																		
Kandidatë rom dhe ballkano-egjiptian	6																		
Kandidatë që aplikojnë për transferim studimesh	7																		
Kandidatë që aplikojnë për program të dytë	8																		
TOTALI		11	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	

Cikli parë

Përgjegjës i Njësisë Bazë të Interpre Prof.Arben LLOZI
Përgjegjës i Njësisë Bazë të KMDDP-s-Prof.Asoc. Dorian ÇENE
Përgjegjës i Njësisë Bazë të Kantos Prof.Asoc. Kastriot TUSHA
Zv.Dekan i FM-së Prof.Asoc. Merita Rexha (TËRSHANAJ)

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu
FAKULTETI I MUZIKES

